



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

V E N D I M

Nr. 240, datë 07.06.2021

“PËR

PEZULLIMIN NGA DETYRA TË MAGJISTRATES {...}

DHE KRYERJEN E HETIMEVE TË MËTEJSHME PËR SHKELJEN DISIPLINORE”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen plenare të datës 07.06.2021, pasi shqyrtoi Kërkesën nr. 2596/13 prot., datë 01.06.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “*Për pezullimin nga detyra të magistrates {...}, me detyrë zëvendëskryetare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Elbasan, deri në përfundimin e procedimit disiplinor*”; pasi u njoh me materialet e procedimit disiplinor të filluar ndaj magistrates {...}, të përcjella në Këshill me Shkresën nr. 2596/12 prot., datë 01.06.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; pasi dëgjoi Inspektorin e Lartë të Drejtësisë që kërkoi pranimin e kërkesës për pezullimin nga detyra të magistrates {...} deri në përfundim të procedimit disiplinor; si dhe pasi dëgjoi magistraten {...} dhe përfaqësuesen e saj, Avokaten Romina Zano, që kërkuan rrëzimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për pezullimin nga detyra,

VËREN:

I. KËRKESAT E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

1. Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është depozituar Kërkesa nr. 2596/12 prot., datë 01.06.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “*Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magistrates {...}, me detyrë zëvendëskryetare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan*”, së bashku me raportin dhe dosjen e hetimit disiplinor, protokolluar në Këshill me aktin nr. 2508/3, datë 01.06.2021.

2. Po ashtu, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është depozituar edhe Kërkesa nr. 2569/13 prot., datë 01.06.2021, e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “*Për pezullimin nga detyra e magistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, deri në përfundimin e procedimit disiplinor*”, protokolluar në Këshill me aktin nr. 2508/4, datë 01.06.2021.

II. HETIMI DHE PROCEDIMI DISIPLINOR I MAGJISTRATES {...}

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë (më poshtë referuar ILD), me Vendimin nr. 2569 prot., datë 31.05.2021, ka filluar me iniciativë hetimin disiplinor ndaj magjistrates {...}, me detyrë zëvendëskryetare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Elbasan, bazuar në nenet 124 dhe 152 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin). Referuar vendimit, si shkak për fillimin me iniciativë të hetimit disiplinor kanë shërbyer disa video të magjistrates të publikuara në rrjetin social “Tik-Tok”, të cilat më pas janë publikuar në datat 30 dhe 31 maj 2021, në median e shkruar dhe atë vizive, si dhe në rrjetet sociale, shoqëruar me lajme e tituj të ndryshëm për magjistraten {...}. Po ashtu referuar vendimit, objekt i hetimit disiplinor është shkelja disiplinore e parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “a”, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, neni 103, paragrafi 1, shkronja “dh”, i Ligjit për Statusin, si dhe nga Kodi i Etikës Gjyqësore, Seksioni “C”, “Parimi i integritetit”, shkronjat “a” dhe “b” dhe Seksioni “Ç”, “Parimi i sjelljes së hijshme dhe me vetëpërbajtje”, pika 9, shkronjat “c” dhe “k”. Ky vendim i është njoftuar rregullisht edhe Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4. Për hetimin disiplinor të kryer është përgatitur Raporti nr. 2596/9 prot., datë 01.06.2021, “Për hetimin disiplinor të magjistrates {...}, me detyrë zëvendëskryetare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Elbasan”.

5. Në përfundim të hetimit disiplinor, me Vendimin nr. 2569/10 prot., datë 01.06.2021, ILD ka vendosur:

“1) Përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistrates {...}, me detyrë Zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, neni 103, paragrafi 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe shkelje të Kodit të Etikës Gjyqësore të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 171, datë 22.04.2021, Seksionit “C” “Parimi i integritetit”, shkronja “a” dhe “b”, Seksioni “Ç”, “Parimi i sjelljes së hijshme dhe me vetëpërbajtje”, pika 9, shkronja “c”.

2) Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates {...}, me detyrë Zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 103, paragrafi 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe shkelje të Kodit të Etikës Gjyqësore të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 171, datë 22.04.2021, Seksionit “C”, “Parimi i integritetit”, shkronja “a” dhe “b”, Seksioni “Ç”, “Parimi i sjelljes së hijshme dhe me vetëpërbajtje”, pika 9, shkronja “c”.

3) Propozimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 105, paragrafi 1,

shkronja “dh” dhe neni 111 pika 1, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

- 4) *Njoftimin e magistrates {...} me Raportin e Hetimit dhe me vendimmarrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, mbi përfundimin e hetimit disiplinor për shkeljet disiplinore të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimit.*
- 5) *Dërgimin e Raportit të hetimit disiplinor së bashku me dosjen hetimore pranë institucionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.*

6. Sipas materialeve të hetimit disiplinor, në datat 30 dhe 31 maj 2021, në median e shkruar dhe atë vizive, si dhe në rrjetet sociale, janë publikuar disa video të publikuara në rrjetin social “Tik-Tok”, shoqëruara me lajme e tituj¹ për magistraten {...}. Në analizë të pamjeve të videove të publikuara, sipas ILD, rezulton se magjistrate {...} me detyrë Zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila ushtron njëkohësisht detyrën e Kryetares së kësaj gjykate, realizon në ambientet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (në zyrën ku ajo ushtron detyrën e Zëvendëskryetarit), si dhe në ambientet e një automjeti tip “BMW”, herë vetëm dhe herë e shoqëruar me të tjerë, video të imazhit të vet personal me lëvizje dhe sjellje provokuese, të shoqëruar në sfond me muzikë të natyrës jo të hijshme dhe të papërshtatshme për imazhin e një magistrati. Videot e realizuara në ambiente të zyrës së kryetarit, në ambiente të tjera të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe në ambientin e një automjeti, janë publikuar në rrjetin social “Tik-Tok”, në llogarinë e hapur me të dhëna {...} në data të ndryshme: 14, 17 dhe 20 maj 2021.

7. Mbështetur në parashikimet e nenit 100, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit për Statusin, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve që kanë lidhje me hetimin disiplinor, ILD ka hetuar kryesisht faktet, si dhe ka vlerësuar rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes. Në të njëjtën kohë, në kuadër të zhvillimit të veprimeve hetimore, bazuar në nenet 132 dhe 152, të Ligjit për Statusin, si dhe nenet 77 dhe 80, të Kodit të Procedurave Administrative, përveç videove të publikuara në median e shkruar dhe atë audiovizive, ILD ka administruar në cilësinë e provës edhe disa dokumente të marra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

¹[] <https://hashtag.al/index.php/2021/05/30/elbasani-nen-sundimin-e-krimit-kryetarja-e-gjykates-perkedhelet-ne-tiktok-video/>

[] <https://www.facebook.com/www.hashtag.al/photos/a.234695586691441/1830950007065983/?type=3&theater>

[] <https://www.gazeta-shqip.com/aktualitet/ne-2019-liroi-nga-burgu-te-fortin-e-bandes-se-gaxhait-kryetarja-e-gjy-i1137826>

[] https://www.youtube.com/watch?v=243pipbYyRE&ab_channel=ShqiptarjaMedia

[] <https://shqiptarja.com/lajm/elbasani-nen-sundimin-e-krimit-kryetarja-e-gjykates-ben-modeling-per-tiktok-duke-sfiluar-ne-zyre-ne-2019-liroi-nga-burgu-te-fortin-e-bandes-se-gaxhait-video>

[] <https://www.gazetatema.net/2021/05/31/videot-krimi-ben-kerdine-ne-elbasan-kryegjyqtarja-ben-video-provokuese-ne-zyre-jam-mafia-mafia-mafia/>

[] <http://www.gazetadita.al/video-rrethi-im-eshte-mafia-kryetarja-e-gjykates-se-elbasanit-ben-modeling-ne-tiktok-ankohet-per-punen-te-shtunen-ild-nis-hetimin-disiplinor/>

[] <https://www.syri.net/politike/426501/elbasani-nen-sundimin-e-krimit-kryetarja-e-gjykates-perkedhelet-ne-tiktok-me-video/>

8. Në të njëjtën kohë, në zbatim të neneve 124 dhe 129, të Ligjit për Statusin, si dhe të neneve 35, 42, 45, 78, të Kodit të Procedurave Administrative, magjistrates {...} i është njoftuar rregullisht vendimi për fillimin e hetimit disiplinor, përveç se i janë bërë të ditur të drejtat dhe detyrimet në kuadër të këtij procesi, si: (i) Të përfaqësohet vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi të zgjedhur sipas parashikimeve në Kodin e Procedurave Administrative; (ii) Aksesimi në dosjen e hetimit duke kërkuar edhe kopje të akteve të saj, në atë masë që është në përputhje me objektin e hetimit; (iii) Të dorëzojë parashtrësë dhe dokumente mbështetëse brenda 24 orëve nga marrja e vendimit të fillimit të hetimit disiplinor²; (iv) Të kërkojë dakordësi mbi marrëveshjen e përbashkët të pranimit lidhur me shkeljen disiplinore që i atribuohet; (v) Të drejtën të njoftohet për çdo vendim që do të merret gjatë hetimit disiplinor; (vi) Të ushtrojë të drejtën e ankimit ndaj atyre vendimeve të njoftuara, për të cilat parashikohet e drejta e ankimit.

9. Në kuadër të hetimit disiplinor, ILD ka vlerësuar me rëndësi për hetimin edhe pyetjen e magjistrates {...}, e cila është njoftuar rregullisht me shkresën nr.2569/1 prot. datë 31.5.2021. Takimi është zhvilluar më datë 01.06.2021, ora 10:00, në ambientet e Zyrës së ILD, ndërsa marrja në pyetje³ e magjistrates {...} është dokumentuar rregullisht nga inspektorët përgjegjës të ngarkuar për hetimin disiplinor. Në këtë rast, sipas aktit përkatës të dokumentimit të veprimit hetimor, magjistratja ka pohuar se në vidiot e publikuara është ajo dhe se ato janë realizuar nga ana e saj, në kohë të ndryshme, gjatë vitit 2020 dhe 2021. Sipas magjistrates, vidiot e realizuara në zyrën e punës janë bërë jashtë orarit zyrtar, kanë ndodhur ndonjëherë, në lodhje apo stres e sipër, për shkak të ngarkesës së punës, por gjithmonë ajo ka qenë vetëm dhe nuk ka qenë kurrë qëllimi i saj që ato të dalin dhe publikohen. Më tej, sipas magjistrates, videot janë bërë nga celulari i saj. Po ashtu, sipas magjistrates, vidiot në zyrën e punës janë bërë thjesht për t'ua treguar familjarëve si pasojë e krenarisë për veten dhe ekzaltimit të momentit e kënaqësisë për detyrën e re, atë të zëvendëskryetarit të gjykatës. Magjistratja ka shpjeguar se nuk ka pasur asnjëherë llogari në rrjetet sociale, por se aparatën e saj celular e përdorin edhe dy fëmijët e saj të mitur, të cilët shkarkojnë programe dhe luajnë dhe ndoshta ata ishin futur dhe uploaduar padashje vidiot e saj, por nuk mund të shpjegonte dot se si ishte vepruar për publikimin e tyre, ndërsa pas publikimit në media të videove kishte konstatuar se llogaria e publikuar ishte çaktivizuar. Sipas magjistrates djali i saj ka pasur llogari në TikTok, por nuk dinte me çfarë emri e kishte hapur atë. Sipas saj, në telefonin e saj kishte një faqe të posaçme vetëm për fëmijët, të cilën ajo nuk e kishte hapur ndonjëherë. Përveç kësaj, magjistratja ka shpjeguar se telefonin e kishte pasur dy herë në servis për riparim. Në përgjigje të pyetjes se si e vlerësonte sjelljen e saj në ambientet brenda gjykatës dhe jashtë saj, referuar pozicionit dhe asaj që përfaqësonte, magjistratja ka shpjeguar se: *“..., absolutisht nuk jam krenare që këto lloj pamjesh kanë dalë në publik. Nuk ka qenë kurrë qëllimi i bërjes së tyre publike. Unë kam studiuar me mish dhe shpirt për të arritur këtu ku jam. Gjithë kohës i jam përkushtuar librave dhe studimit, dhe dita ime fillon në orën 8 dhe mbyllet në orën 4, pas kësaj deri në orën 10-11 merrem me arsyetimin e vendimeve. Shyqyr kam prindërit që mi mbajnë dhe përkujdesen për fëmijët, kështu që kam dy vjet që e kam neglizhuar rritjen dhe*

² Shih dispozitivin e vendimit të hetimit disiplinor nr. 2569 prot., datë 31.05.2021

³ Procesverbali i mbajtur nga inspektorët përgjegjës më datë 1.6.2021

përkujdesjen e tyre dhe kjo është arsyeja mbase që kur kthehem në shtëpi ku ti lej një telefon, një gjë, që të më lënë pak pushim se jam e lodhur. Në punë jam e përkushtuar, korrekte, serioze, edhe pse jam në pozicionin e zëvendëskryetares domethënë kam 50% me shumë ngarkesë në ditë, por nuk ka ditë që unë të mos bëj 5 ose 6 gjyqe, më shumë se sa gjyqtarët e tjerë. Arsyetimet i bëj në kohë rekord, përpiqem të jap drejtësi në përputhje me ligjin dhe Kushtetutën. Nuk kam cënuar asnjëherë nga ajo për të cilën jam betuar, të jap drejtësi dhe të respektoj të drejtat e njerëzve. Edhe në jetën private jam shumë e kontrolluar, fundjava ime është mbase një ditë me bashkëshortin dhe fëmijët dhe pjesa tjetër sërish arsyetim vendimesh. Në kaq rrotullohet e gjithë gjëja, jeta, dhe mbase kjo është një formë heqje stresi që të ndodh ndonjëherë ndaj bëj ndonjë foto apo video, por kurrë gjatë orarit të punës pasi përveç gjyqeve jam shumë e zënë me pjesën e administrimit dhe menaxhimit të gjykatës”. Më tej, në përgjigje të pyetjes nëse nxjerrja e videove ishte një pakujdesi e fëmijëve apo mendonte se kjo gjë ishte bërë nga dikush me qëllim dëmtimin e imazhit të saj, magjistratja ka shpjeguar se: “Nuk mund ta ndaj arsyen pse ka ndodhur, thashë fëmijët kanë llogari TikToku të cilat nuk as i hapja dhe as nuk i shikoja, dhe përpos kësaj celulari im ka qenë disa herë në servis, ndaj nuk e di, jam e paqartë edhe vetë”. Ndërsa në përgjigje të pyetjes nëse kishte pasur presion në ushtrimin e detyrës nga eksponentë, pjesëtarë në procese gjyqësore apo familjarë të tyre, magjistratja ka shpjeguar se: “Jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, por presioni ndihet në varësi të llojit të çështjes apo situatës. Çdo çështje që ke dhe çdo vendim që merr është përgjegjësi dhe ndoshta krijohet pakënaqësi tek të tretët, që jo gjithmonë t’i shfaqin këto pakënaqësi apo t’i bëjnë me dije, sepse njerëzit e bëjnë këtë edhe në fshehtësi, për të shprehur pakënaqësinë e tyre”.

10. Në parashtrimet me shkrim, të depozituara më datë 01.06.2021, magjistratja {...} pretendon se shkelja disiplinore që i atribuohet sipas vendimit të fillimit të hetimit disiplinor, ajo sipas nenit 103, paragrafi 1, shkronja “dh”, të Ligjit për Statusin, ishte shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese me Vendimin nr.34/2017 dhe ky vakum ligjor nuk ishte plotësuar. Po ashtu, magjistratja ndërsa ka pohuar realizimin e videove, ka pretenduar se ato janë kryer jashtë orarit zyrtar apo në automjet privat dhe si të tilla këto veprime nuk ishin të ndaluara dhe nuk përbënin shkelje të rëndë profesionale ose etike, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës. Magjistratja ka pretenduar gjithashtu se ka qenë vetëm kur ka bërë filmimet dhe se nuk kishte kryer ndonjë veprim që cenonte integritetin e gjyqtarit dhe as veprime të pahijshme në drejtim të dosjes, të pelerinës, të sallës së gjyqit apo me elementë të tjerë, që mund të lidhen me ushtrimin e profesionit. Magjistratja po ashtu ka pretenduar se videot e publikuara nuk kanë pasur asnjë ndikim në profesionalizimin e saj dhe as në aftësitë e saj si gjyqtare, si dhe se nuk kanë ndikuar në dhënien e ndonjë vendimi të padrejtë. Së fundi, magjistratja ka pretenduar se ajo nuk kishte llogari në rrjete sociale dhe se nuk ka qenë ajo personi që ka publikuar videot dhe, për rrjedhojë, nuk qëndronte pretendimi për sjellje jo etike, që i atribuohet sipas Seksionit “Ç”, shkronja “k”, të Kodit të Etikës Gjyqësore.

11. Në raportin e hetimit disiplinor, mbi bazën e të cilit ILD ka vendosur dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates {...}, bazuar në të dhënat administruara gjatë hetimit

disiplinor, është vlerësuar se sjellja dhe qëndrimi i magistrates në video të ndryshme, të realizuara në ditë të ndryshme, në ambiente të ndryshme, është jo etike dhe vijuese, përveç se një sjellje e tillë ishte realizuar edhe në prani të një të mituri, i cili ndodhet në sediljen e pasme të automjetit, ndërsa ka qenë pasagjere. Kjo sjellje e magistrates përbënte “*Shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit*” dhe se ajo vlerësohej si “*Shkelje shumë të rëndë disiplinore*” duke mbajtur në konsideratë: (i) natyrën e shkeljes disiplinore që referon në sjellje dhe veprime të pahijshme dhe pa vetëpërmbytje të magistrates në ambiente të Zyrës së Kryetarit të Gjykatës dhe në automjet; (ii) kryerjen e shkeljes disiplinore nga ana e magistrates me dashje direkte; (iii) ekzistencën e rrethanës rënduese, pasi shkeljet janë të vazhdueshme duke vijuar me të njëjtën sjellje në videot e realizuara pas datës 30.09.2020 si dhe në vitin 2021, të cilat dokumentohen të jenë të ndryshme dhe të publikuara në rrjetin social “Tik-Tok” në datat; 14, 17 dhe 20 Maj 2021; (iv) përvojën e magistrates në sistemin gjyqësor; (v) cenimin e imazhit të sistemit gjyqësor dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë; (vi) ekzistencën e rrezikut të shkakuar nga shkelja disiplinore pasi sjellja e papërshtatshme e magistrates subjekt hetimi disiplinor, sjellje e cila rrezikon të ndiqet si shembull nga magistratë të tjerë jo vetëm të të njëjtës gjykatë, krijon terren për sjellje të papërshtatshme dhe në raste të tjera të ngjashme, me rrezik serioz në besimin e publikut në administrimin e drejtësisë; (vii) mungesën e ndonjë arsye specifike që është jashtë kontrollit të magistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor.

III. KËRKESA PËR MARRJEN E MASËS PROVIZORE TË PEZULLIMIT NGA DETYRA TË MAGJISTRATES {...}

12. Ndërkohë, krahas kërkesës për shqyrtimin e procedimit disiplinor, bazuar në nenin 152 të Ligjit për Statusin, me Kërkesën nr. 2596/13 prot., datë 01.06.2021, ILD i ka kërkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë *pezullimin nga detyra të magistrates {...}, deri në përfundimin e procedimit disiplinor*”.

13. Për këtë kërkesë, ILD argumenton se masa provizore e pezullimit nga detyra të magistrates deri në përfundimin e procedimit disiplinor përbën në vetvete një veprim procedural, në kuadër të një procedimi disiplinor të filluar, që duhet të vendosej nga Këshilli mbi kërkesën e motivuar të tij (ILD), kërkesë kjo që gjente mbështetje në nenin 140, pika 3, shkronja “c”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sikundër edhe në nenin 152 të Ligjit për Statusin. Sipas ILD, pezullimi nga detyra i magistrates së proceduar disiplinarisht duhet të vendosej për shkak se ekzistonte një dyshim i arsyeshëm se vazhdimi në detyrë i saj mund të diskreditonte rëndë figurën dhe pozitën e magistratit.

IV. PROCEDURA E NDJEKUR NGA KËSHILLI

14. Pas depozitimit të Kërkesës së ILD nr. 2596/12 prot., datë 01.06.2021, “*Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magistrates {...}, me detyrë zëvendëskryetare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan*”, si dhe të Kërkesës të ILD nr. 2569/13 Prot., datë 01.06.2021, “*Për pezullimin nga detyra e magistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor*”.

Elbasan, deri në përfundimin e procedimit disiplinor”, Këshilli i Lartë Gjyqësor nisi menjëherë shqyrtimin e tyre ku fillimisht, pas shortit të hedhur, bazuar në nenin 63 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me Vendimin nr. 222, datë 02.06.2021, si relator për procedimit disiplinor ndaj magjistrates {...}, u caktua anëtari i Komisionit Disiplinor, z. Maksim Qoku. Ky vendim iu njoftua palëve, me Shkresën nr. 2543/2 prot., datë 03.06.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

15. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, duke mos konstatuar mangësi të tij dhe as ekzistencën “*prima facia*” të ndonjë prej rasteve të përcaktuara në nenin 138 të Ligjit për Statusin, për mbylljen e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore, relatori i çështjes i propozoi Këshillit të Lartë Gjyqësor të vijonte me shqyrtimin e kërkesës së ILD për pezullimin e përkohshëm nga detyra të magjistrates {...}.

16. Në kushtet kur procedimi disiplinor ndaj magjistrates {...} është paraqitur sipas nenit 152, pika 1, të Ligjit për Statusin, ndërsa pika 2 e kësaj dispozite përcakton detyrimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për shqyrtimin e kërkesës për pezullim e përkohshëm nga detyra të magjistratit të proceduar disiplinorisht brenda 3 ditëve nga paraqitja e saj, kjo kërkesë u shqyrtua në mbledhjen plenare të datës 7 Qershor 2021, në rrethanat kur dy ditët pararendëse të saj nuk ishin ditë pune (e shtunë dhe e diel), referuar për këtë përcaktimit të shkronjës “c”, neni 2, të Ligjit për Statusin.

17. Seanca dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës për pezullim e përkohshëm nga detyra u zhvillua në prani të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë z. Artur Metani dhe të magjistrates së proceduar disiplinorisht, gjyqtarës {...}, si dhe përfaqësueses së saj të zgjedhur me deklaram para Këshillit të Lartë Gjyqësor, Avokates {...}.

V. PARASHTRIMET E PALËVE NË SEANCË DËGJIMORE

18. Inspektori i Lartë i Drejtësisë depozitoi me shkrim argumentet mbi kërkesën për pezullimin nga detyra e magjistrates {...} deri në përfundimin e procedimit disiplinor⁴, të cilat i parashtrroi dhe verbalisht.

19. Konkretisht, Inspektori i Lartë i Drejtësisë parashtrroi se:

“Në mbështetje të vendimit për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates {...}, Inspektori bazuar në nenin 140, pika 3, shkronja “c”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 152, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, paraprakisht vlerësohet se në rastin konkret ekzistojnë kushtet ligjore për caktimin ndaj magjistrates {...} të masës provizore të pezullimit nga ushtrim i detyrës deri në përfundimin e procedimit disiplinor, për shkak se vazhdimi i magjistratit në detyrë diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit.

⁴ Shkresa nr. 2569/14 prot., datë 07.06.2021, protokolluar në Këshill me aktin nr. 2508/5, datë 07.06.2021.

Në rastin konkret, si dhe duke cilësuar Raportin e Hetimit Disiplinor, duhen mbajtur në konsideratë rrethanat e dyshuara të kryerjes së shkeljes disiplinore (natyrën e shkeljes), të cilat kanë të bëjnë me cenimin e standardeve të sjelljes së një magjistrati dhe etikës gjyqësore, e cila duhet të zbatohet për shkak të funksionit, prandaj dhe është krijuar një dyshim i arsyeshëm, se vazhdimi në detyrë i magistrates {...} diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magistratit.

Në të njëjtën kohë, në varësi të kompleksitetit të veprimeve hetimore, si dhe provave të administruar në kuadër të këtij procedimi disiplinor rezulton qartë se burimi i informacionit është i besueshëm, në rastin konkret krijohet një dyshim i arsyeshëm se vazhdimi në detyrë i magistrates {...} diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magistratit, si dhe në raportin për zhvillimin e hetimit disiplinor nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë arsyetuar të gjithë elementët faktik dhe juridikë në lidhje me shkeljet disiplinore dhe përgjegjësinë disiplinore të magistrates {...}.

Masa provizore e pezullimit nga ushtrimi i detyrës deri në përfundimin e procedimit disiplinor të magistratit, përbën në vetvete një veprim procedural, në kuadër të një procedimi disiplinor të filluar, e cila vendoset nga Këshilli mbi kërkesën e motivuar të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ose dhe nga vetë Këshilli kryesisht.

Gjyqtari duhet të ruajë dhe zbatojë standarde të larta të sjelljes dhe duhet t'i respektojë personalisht këto standarde, në mënyrë që integriteti dhe pavarësia e gjyqësorit të ruhen. Gjyqtari sillet gjithmonë në mënyrë të tillë që të ruajë dinjitetin, si dhe sjellja dhe qëndrimi i gjyqtarit duhet të rikonfirmojë besimin e qytetarëve tek integriteti i gjyqësorit. Gjyqtari duhet kujdeset për ruajtjen e integritetit si gjatë ushtrimit të detyrës, ashtu dhe në jetën e tij private, me qëllim garantimin e besimit të publikut tek sistemi gjyqësor.

Qëllimi i parashikimeve ligjore është rikthimi i besimit të publikut në sistemin gjyqësor. Duke marrë shkak nga rrethanat e kryerjes së shkeljes disiplinore nëse magjistrati do të vazhdonte të qëndronte në detyrë rrezikon të dëmtojë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë deri sa procedimi disiplinor të përfundojë.

Për sa më sipër në mbështetje të nenit 152, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kërkojmë pezullimin nga detyra të magistrates {...} me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan deri në përfundimin e procedimit disiplinor”.

20. Magjistratja e proceduar disiplinarisht, znj. {...}, fillimisht depozitoi me shkrim dorëheqjen e saj nga pozicioni i Zëvendëskryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Kjo dorëheqje, ndërsa përmbante vullnetin e lirë të magistrates për heqjen dorë nga ushtrimi i një funksioni administrativ në të cilin ishte zgjedhur, bazuar në nenin 26 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nuk mund të përbente objekt shqyrtimi nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Nga ana tjetër, kjo dorëheqje mbetet të pranohej si e tillë, për sa kohë ligji nuk ka rregullime specifike për dorëheqjen nga detyra e zëvendëskryetarit të gjykatës, duke mos përcaktuar ndonjë afat për dhënien ajo të efekteve juridike dhe as kërkuar miratimin e saj

ose deklarimin formal të mbarimit të këtij funksioni, si rregull nga organi që ka kompetencën e zgjedhjes.

21. Në parashtrimet e saj përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor magjistratja e proceduar disiplinarisht deklaroi se ishte shumë e vështirë për të, si gjyqtare e Republikës së Shqipërisë, por edhe si nënë e grua, të dilte përpara tij për të folur për jetën e saj personale, të bërë publike përmes videove të pa hetuara se nga dolën. Nga ana tjetër, ajo kërkoi ndjesë të thellë publike dhe deri në gjetjen e vërtetësisë, shpresonte që zëri i saj të dëgjohej, të besohej dhe të vlerësohej në bazë të parimit të proporcionalitetit dhe jo vetëm.

22. Sipas magjistrates, i vetmi mëkat i saj për të cilin ajo dilte kokulur përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor, ishte filmimi i videove krejtësisht private, krejtësisht të saj, ndërsa po gjykohej për veshjen, për pamjen apo për shijet e saj muzikore, të cilat nuk kishin ndodhur aspak gjatë ushtrimit të detyrës, të cilat nuk ndikonin aspak në marrjen e vendime gjyqësore, të cilat nuk ndryshonin aspak të qenurit gjyqtare, të cilat nuk kishin impakt aspak dhe asesi në ushtrimin e detyrës së zëvendëskryetares së gjykatës, si dhe të cilat nuk ndikonin në paanshmërinë dhe pavarësinë e saj si gjyqtare.

23. Në funksion të kërkesës për pezullimin nga detyra, magjistratja kërkoi që të mbahej në konsideratë se kishte përfunduar studimet, në arsimin e mesëm, atë universitar dhe pasuniversitar, me rezultate të larta dhe se në 7 vitet e ushtrimit të detyrës së gjyqtarit asnjëherë për të nuk ishin konstatuar shkelje dhe asnjëherë nuk ka qenë e denoncuar apo e dyshuar për korrupsion në vendimmarrjet e saj, ndërsa kishte punuar me përkushtim, përgjegjshmëri dhe devotshmëri, madje duke hequr dorë nga jeta private dhe familjare, ndërkohë që ishte nënë e dy fëmijëve të mitur. Po kështu, magjistratja pretendoi se për të gjykuar atë, Këshilli do të duhet të kishte një tablo të asaj çka ajo përfaqësonte si gjyqtare, si profesioniste, pikërisht të dhëna për rezultatet e punës së saj sa i përkiste ngarkesës së përballuar, korrektësisë në sallën e gjykatës, trajtimit të palëve në proces, respektimin e afatit të dorëzimit të vendimeve apo dhe si menaxhere e gjykatës në cilësinë e zëvendëskryetares në mungesë të kryetarit, për urdhrat dhe vendimet e nxjerra dhe ndryshimin e mënyrës së menaxhimit të punës dhe çështjeve në tërësi. Magjistratja supozoi se korrektësia si gjyqtare profesioniste dhe mënyra e menaxhimit të gjykatës në drejtim të shpërndarjes, trajtimit dhe administrimit të çështjeve, mund të ishin shkaqet e asaj shtate me të cilën po përballej, sipas saj e stisur dhe e qëllimshme nga bota e krimin, ndërsa ishte e bindur se u bë thjesht “kokë turku” e atyre që nëpërmjet saj nuk arritën dot qëllimet e tyre.

24. Përfaqësuesja ligjore e magjistrates {...} paraqiti verbalisht kundërshtimet me shkrim të magjistrates, rreth procedimit disiplinor dhe kërkesës për pezullim nga detyra, duke parashtruar faktet dhe rrethanat, ligjin, analizën dhe arsyetimin ligjor të fakteve, mbi të cilën arrihej në përfundimin se kërkesa e ILD për pezullimin nga detyra të magjistrates ishte e haptazi e pabazuar në prova dhe ligj, ku mbi këtë bazë Këshilli të Lartë Gjyqësor i kërkoi rrëzimi i kërkesës.

25. Konkretisht, në kundërshtimet e magjistrates u parashtrua se:

“... ”

11.1 Së pari, vetë Inspektori i Lartë i Drejtësisë në shkresën nr.2569/12 prot., datë 01.06.2021, kërkesën për shkarkim e mbështet në nenin 140, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 103, shkronja “dh” të ligjit nr.96/2016 që bën fjalë për “Shkeljet jashtë ushtrimit të funksionit”, pra jo për shkelje të “gjqtarit gjatë ushtrimit të detyrës. Ndërkohë që Kushtetuta, pa lënë shteg për mëdyshje, ka parashikuar në mënyrë shteruese si rastet e shkarkimit ashtu dhe rastet e pezullimit të gjyqtarit nga detyra, si garanci për ushtrimin normal të detyrës, duke mos e lënë në diskrecion të ligjvënësit të parashikonte motive të ndryshme shkarkimi nga ato që ka parashikuar vetë Kushtetuta. Pra, për sa i përket motiveve të shkarkimit është parashikuar rezerva kushtetuese. Kështu, në nenin 140, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet shprehimisht: “2. Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës”. Në rastin konkret vetë Inspektori i Lartë i Drejtësisë konfirmon faktin që unë nuk kam kryer asnjë shkelje profesionale ose etike gjatë ushtrimit të detyrës sikurse parashikohen në mënyrë shteruese në nenin 102 të ligjit nr. 96/2016, nën titullin “Shkelje disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit”. Ndodhur në këto kushte, çmoj se në respektim të “parimit të shtetit të së drejtës”, si dhe në respektim të “parimit të ligjshmërisë” sanksionuar në nenin 100, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 96/2016, nuk mund të vendoset masa disiplinore e “Shkarkimit nga detyra” për sjellje që ligji nuk i kualifikon gjatë ushtrimit të detyrës/funksionit të gjyqtarit. ...

11.2 Së dyti, Kodi i Etikës Gjyqësore në vendimin nr. 171 seksioni ç, pika 9, shkronja k dhe c parashikon se ... Mendoj dhe vlerësoj se veprimet e mia lidhur me regjistrimin e disa videove jashtë orarit zyrtar të punës apo në makinë në jetën time private nuk përbëjnë shkelje disiplinore në kuptim të bazës ligjore të sipërcituar. Mendoj se zyra ime nuk është përdorur për ndonjë veprimtari tjetër të ndryshme nga ajo e gjyqësorit vetëm për faktin që unë kam realizuar disa video të cilat i mbaja në telefonin tim, për të cilat nuk kam pasur kurrë qëllim të dilnin në publik. Veprimet e mia në video nuk përbëjnë shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës. Gjatë këtyre videove unë jam vetëm në zyrën time pa praninë e askujt dhe aq më tepër nuk kam kryer ndonjë veprim që të cenoj integritetin e gjyqësorit, as kam bërë veprime të pahijshme në drejtim të dosjeve të cilat kam qenë duke i punuar, as në drejtim të pelerinës, të sallës së gjyqit apo me element të tjerë që mund të lidhen drejtpërdrejtë me ushtrimin e profesionit. Nuk kam qenë duke konsumuar alkool, cigare apo ndonjë lëndë të ndonjë lloji tjetër, duke takuar palë, avokat, apo duke kryer ndonjë akt korruptiv. Kam qenë dhe jam shumë e kujdesshme në jetën time private dhe familjare, si në sjellje, veprime, veshje, etj. Për shkak të stresit të punës dhe të qenit e mbyllur gjithë kohës në një zyrë për të punuar me përkushtim, edhe gjatë kohës që duhet të isha duke kaluar me familjen apo miqtë e mi, ndodh që nga kjo lodhje dhe stres bëj video të vetes time. Edhe pse duke arsyetuar vendime pas orarit zyrtar të punës, jo me dashakeqësi dhe

as me qëllime të caktuara. Gjatë gjithë periudhës time profesionale kam dhënë kontributin maksimal në ushtrimin e këtij profesioni dhe jam përpjekur të krijojë besimin e publikut në dhënien e drejtësisë, gjë të cilën mendoj se e kam arritur me sukses. Videot e publikuara nuk kanë pasur kurrë ndikim në profesionalizimin tim dhe as në aftësitë e mia si gjyqtare. Këto video nuk kanë ndikuar në dhënien e ndonjë vendimi të padrejtë.

11.2.1 Sipas pikës k) të Kodit të Etikës Gjyqësore gjyqtari shfaq vetëpërmbytje në përdorimin e medias dhe rrjeteve sociale. Së pari nga kjo kuptohet se gjyqtari nuk e ka të ndaluar të përdor asnjë rrjet social apo të bëj publikime në to, por thjesht duhet të tregojë vetëpërmbytje. Megjithatë dua të theksoj se këto video nuk janë nxjerr nga unë personalisht dhe as ka qenë kurrë ky qëllimi im. E pavarësisht kësaj janë mediat ato që i kanë shpërndarë dhe i kanë bërë publike ato, kundër dëshirës time dhe me dashakeqësi apo thjesht për të qenë “ushqim” për ta, për disa ditë duke përfutuar ndoshta nga inocenca e fëmijëve të mi gjatë përdorimit të programeve të ndryshme. Vërtet videot janë zhvilluar në zyrën e shtetit por kurrsesi nuk kam cenuar ndonjë element të drejtësisë që mund të cenojë besimin e publikut tek drejtësia dhe tek aftësia ime për të dhënë drejtësi në të ardhmen.

11.3 Së treti, në nenet 100, pika 1, shkronja “c” dhe 115, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016, Inspektori i Lartë i Drejtësisë duhet të kishte arsyetuar parimin e proporcionalitetit kur ka kërkuar masën disiplinore ndaj meje. Në nenin 17 të Kushtetutës parashikohet shprehimisht se: “1. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendoset vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropianë për të Drejtat e Njeriut”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut mund të bëhet vetëm nëse plotësohen në mënyrë kumulative këto kushte: i) Kufizimi duhet të vendoset me ligj. Shprehja “vetëm me ligj” ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, atëherë ky vlerësim është në diskrecionin vetëm të ligjvënësit dhe jo të organeve të tjera, përfshirë edhe Këshillin e Ministrave. Përdorimi i kësaj shprehje nuk është i rastit, por është bërë për të treguar se kufizime të tilla nuk mund të vendosen me ndonjë akt tjetër përveç ligjit. ; ii) Kufizimi duhet të bëhet për një interes publik. iii) Një kusht tjetër që duhet të respektojë ligjvënësi në vendosjen e kufizimit është që ky kufizim të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Ky kusht e imponon ligjvënësin të evidentojë nevojën reale të ndërhyrjes në të drejtat individuale në një situatë konkrete. iv) Kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore nuk mund të cenojë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

11.3.1 Nëse vërtetë do të kishte ndonjë shkelje etike, Inspektori i Lartë i Drejtësisë duhet të mbante në konsideratë faktin si: i) unë jam magjistrate e re në detyrë; ii) kam përfunduar Shkollën e Magjistraturës me rezultate shumë të mira, ku jam renditur e dyta në përfundim të studimeve; iii) nuk kam kryer asnjë shkelje disiplinore më parë; iv) janë mbyllur rrjetet sociale nga ana ime që të mos ndodhin në të ardhmen asnjë mundësi që të publikohen qoftë edhe nga

pakujdesia ndonjë video apo foto që lidhet me jetën private. Pra, nga ana ime janë marrë masa në mënyrë aktive për të zhdukur ose pakësuar pasojat që rrjedhin nga publikimi i një video në zyrë jashtë orarit zyrtar e që nuk ka asnjë lidhje me ushtrimin e detyrës/funksioneve gjyqësore apo administrative; v) jam nënë me dy fëmijë të mitur për t'u rritur dhe të vetmet të ardhura janë pagat. Pra, unë kam përgjegjësi thelbësore familjare. Kjo më bën që të jem tepër e përkushtuar gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtare dhe zëvendëskryetare, ku askush nuk ka pasur ndonjë ankesë lidhur me veprimtarinë time profesionale. Të gjitha këto fakte nëse do të ishin marrë në konsideratë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në respektim të parimit të proporcionalitetit, objektivitetit dhe drejtësisë, kurrsesi nuk mund të kërkonte masën ekstreme atë të “Shkarkimit nga detyra” e gjyqtarit. Përkundrazi është haptazi disproporcionale dhe përbën precedent të rrezikshëm duke e larguar edhe Këshillin e Lartë Gjyqësor nga misioni i tij për të garantuar pavarësinë e gjyqësorit, ku një nga elementet e tij është palëvizshmëria e gjyqtarit nga detyra për shkaqe të paparashikuara nga ligji.

11.4 Së pesti, në nenin 152 të ligjit nr. 96/2016 “Pezullimi në rastin e procedimit disiplinor” parashikohet shprehimisht se: ... Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se masa provizore e pezullimit nga detyra jepet vetëm nëse ndodhemi përpara këtyre rasteve: i) kur vazhdimi i magjistratit në detyrë dëmton rezultatin e procedimit disiplinor; ii) kur vazhdimi i magjistratit në detyrë pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt, ose diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit. Në rastin konkret nuk plotësohet asnjë prej kushteve për pezullimin nga detyra. Kjo për faktin se tashmë hetimi disiplinor ka përfunduar, të gjitha provat janë mbledhur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe nuk ka asnjë indicje që unë mund të ndikoj apo të dëmtoj procedimin disiplinor. Gjithashtu, në kushtet kur nuk ndodhemi përpara rastit të “Shkarkimit nga detyra” për arsytet e cituara në paragrafin 11.1 të këtij parashtrimi nuk ka sens logjik dhe juridik të diskutohet diskreditimi i rëndë i figurës dhe pozitës së magjistratit. ...”.

VI. LIGJI I ZBATUESHËM

26. Në rastin konkret është e zbatueshme Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila në nenin 140 parashikon se: “1. Gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit. 2. Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës; b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi. 3. Gjyqtari pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor kur: a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale; b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje; c) kur fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit. 4. Kundër vendimit të shkarkimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese.”

27. Po ashtu, në rastin konkret është i zbatueshëm edhe Ligji për Statusin, i cili:

- në nenin 3, titulluar “Vlerat themelore”, parashikon se:

“1. Magjistrati ushtron funksionet e tij, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.

2. Magjistrati ushtron funksionet në mënyrë të pavarur, duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brendshme, i lirë nga çdo ndikim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye.

3. Magjistrati nuk duhet të krijojë kontakte të papërshtatshme dhe nuk duhet të ndikohet nga pushteti ekzekutiv ose nga pushteti legjislativ. Magjistrati duhet të marrë çdo masë për të qenë dhe të duket se është jashtë çdo ndikimi prej tyre. Magjistrati njofton menjëherë Këshillin dhe kryetarin, në rast se evidenton ndërhyrje ose ushtrim të ndikimit të papërshtatshëm ndaj tij.

4. Magjistrati ushtron funksionet gjyqësore në mënyrë të paanshme, pa ndikim dhe pa paragjykim.

5. Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces. Magjistrati ushtron funksionet me drejtësi, në mënyrë korrekte, në kohë të arsyeshme, të ndërgjegjshme, të kujdesshme, të zellshme dhe sistematike, me objektivitet, vetëpërmbytje dhe maturi”;

- në nenin 4, titulluar “Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes”, parashikon se:

“1. Magjistrati merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera edhe kur magjistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare.

2. Magjistrati merr të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar:

a) dinjitetin dhe standardet e funksionit të tij;

b) reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe atë të prokurorisë;

c) statusin e funksionit të magjistratit.

3. Në përputhje me parashikimet e këtij neni, Këshillat publikojnë standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes.

4. Secili Këshill emëron magjistratin si këshilltarin e etikës, sipas parashikimeve të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”;

- në nenin 103⁵, titulluar “Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit”, parashikon se:

“Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si më poshtë:

a) shkelja e rregullave të papajtueshmërisë me funksionin e magjistratit ose të kufizimeve për shkak të funksionit, sipas parashikimeve të bëra në nenet 6 dhe 7, të këtij ligji;

⁵ Ndryshuar me Ligjin 48/2019.

b) përdorimi i statusit të magjistratit, me qëllim krijimin e përfitimeve për vete ose për të tjerët;

c) ushtrimi i veprimtarive, me pagesë, jashtë funksionit, pa miratimin paraprak të Këshillit;

ç) shoqërimi me persona që janë nën ndjekje penale, janë subjekt të një procedimit penal ose me persona të dënuar dhe të parehabilituar, kur nuk kanë lidhje të ngushta gjaku ose ligjore me magjistratin ose vendosja e marrëdhënieve të papërshtatshme të biznesit me këta persona;

d) përfitimi i padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji, të cilat jepen për shkak të funksionit që ushtron ose si rrjedhojë e shfrytëzimit të pozicionit të magjistratit, edhe në rastin kur formalizohen me një veprim juridik;

dh) raste të tjera të sjelljes që diskrediton pozitën dhe figurën e magjistratit dhe dëmton besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, të kryera jashtë ushtrimit të detyrës”;

- në nenin 152⁶, titulluar “Pezullimi në rastin e procedimit disiplinor”, parashikon se:

“1. Kur ka dyshim të arsyeshëm se vazhdimi i magjistratit në detyrë dëmton rezultatin e procedimit disiplinor, pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt, ose diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen menjëherë një hetim paraprak për të verifikuar besueshmërinë e burimit të informacionit, sipas nenit 124, të këtij ligji, ose ankesës së paraqitur nga subjektet e përcaktuara në nenin 119 të këtij ligji. Kur Inspektori i Lartë i Drejtësisë krijon bindjen se burimi i informacionit ose ankesa është e besueshme, brenda 3 ditëve nga marrja e ankesës ose nga momenti që ka marrë dijeni për shkeljen e pretenduar, i paraqet Këshillit përkatës raport të arsyetuar, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura deri në atë moment për fillimin e një procedimi disiplinor dhe kërkesën për pezullimin e magjistratit nga detyra.

2. Këshilli, për rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, ose në nenin 138, të këtij ligji, pezullon magjistratin nga detyra, kur vazhdimi i magjistratit në detyrë dëmton rezultatin e procedimit disiplinor, pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt, ose diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit. Këshilli mund të kërkojë, informacion mbi shkeljen e pretenduar pranë çdo institucioni publik ose subjekti privat. Në rastin e procedimit disiplinor, sipas pikës 1, të këtij neni, Këshilli vendos menjëherë, por jo më vonë se tre ditë nga data e paraqitjes së kërkesës, duke i dhënë mundësinë magjistratit për të parashtruar argumentet e tij në mbledhjen e Këshillit.

3. Pezullimi, sipas këtij neni, zgjat deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Këshilli mbi kërkesën për procedim disiplinor, me përjashtim të rastit kur Këshilli vendos të revokojë pezullimin, sipas nenit 156 të këtij ligji.

⁶ Ndryshuar me Ligjin 15/2020.

4. Pavarësisht parashikimeve të nenit 138, pika 5, të këtij ligji, Këshilli, kur çmon se ka nevojë për hetime të mëtejshme për shkeljen disiplinore, i kërkon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të kryejë këto hetime, pa qenë nevoja për të specifikuar elementet që mungojnë dhe afatin. Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen me përparësi hetime të mëtejshme për këto shkelje dhe i paraqet Këshillit raportin dhe dosjen e hetimit”;

- në nenin 153, titulluar “Fillimi i procedimit të pezullimit”, parashikon se:
“Pezullimi nga detyra i magjistratit, në kuptimin e nenit 152, mund të vendoset nga një Këshill:
a) me nismën e vet;
b) me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
- në nenin 155, titulluar “Vendimet e pezullimit dhe ankimet”, parashikon se:
“1. Vendimi për pezullimin nga detyra, sipas parashikimit të neneve 151 dhe 152, të këtij ligji, merret nga Këshilli brenda tre ditëve pas paraqitjes së kërkesës ose informacionit.
2. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin për pezullimin nga detyra në gjykatën kompetente.
3. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vendimin për pezullimin nga detyra të magjistratit”;
- në nenin 156⁷, titulluar “Kufijtë e kohëzgjatjes së pezullimit”, parashikon se:
“1. Pezullimi i magjistratit, i parashikuar në nenet 151 dhe 152, të këtij ligji, vendoset për një periudhë të caktuar kohe dhe nuk mund të vazhdojë nëse arsyet e pezullimit, të parashikuara në këto nene, pushojnë së ekzistuari.
2. Këshilli kryesisht ose me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë apo të magjistratit mund të rishikojë pezullimin e parashikuar në nenet 151 dhe 152, të këtij ligji, dhe vendos sipas rastit:
a) ndryshimin e kohëzgjatjes së pezullimit;
b) revokimin e pezullimit; ose
c) lënien në fuqi të pezullimit”.

28. Gjithashtu, në rastin konkret është i zbatueshëm edhe Kodi i Etikës Gjyqësore⁸, i cili:

- në Kreun I, titulluar “Dispozita të përgjithshme”, parashikon se:

⁷ Ndryshuar me Ligjin 48/2019.

⁸ Miratuar me Vendimin nr.171, datë 22.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe botuar në Fletoren Zyrtare nr. 66, datë 29 prill 2021.

- “1. Standardet e etikës gjyqësore dhe rregullat e sjelljes të gjyqtarit, në vijim Kodi i Etikës Gjyqësore, janë tërësia e parimeve, normave dhe rregullave, të cilat udhëheqin sjelljen e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës dhe veprimtarisë së tij jashtëgjyqësore.
2. Kodi i Etikës Gjyqësore synon të garantojë rritjen dhe forcimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe dhënien e drejtësisë në përputhje me Kushtetutën, standardet e njohura ndërkombëtarisht të të drejtave të njeriut dhe ligjin.
3. Gjyqtari duhet të ruajë dhe zbatojë standarde të larta të sjelljes dhe duhet t'i respektojë personalisht këto standarde, në mënyrë që integriteti dhe pavarësia e gjyqësorit të ruhen. Dispozitat e këtij Kodi duhet të interpretohen dhe zbatohen për të arritur këtë objektiv.
4. Kodi i Etikës Gjyqësore zbatohet nga të gjithë gjyqtarët e sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Pjesë të këtij Kodi, të cilat kanë të bëjnë me jetën private, kanë natyrë këshillimore dhe zbatohen, për aq sa është e mundur, edhe nga gjyqtarët e komanduar në pozicione të tjera. ...”;
- në Kreun II, titulluar “Parimet bazë të Kodit të Etikës Gjyqësore” dhe specifikisht në Seksionin “C”, titulluar “Parimi i integritetit”, parashikon se:
- “8. Gjyqtari sillet gjithmonë në mënyrë të tillë që të ruajë dinjitetin, përgjegjësitë në funksion dhe paanshmërinë e pavarësinë e gjyqësorit. Sjellja dhe qëndrimi i gjyqtarit duhet të rikonfirmojë besimin e qytetarëve tek integriteti i gjyqësorit. Sipas këtij parimi, gjyqtari:
- a) kujdeset për ruajtjen e integritetit si gjatë ushtrimit të detyrës, ashtu dhe në jetën e tij private, me qëllim garantimin e besimit të publikut tek sistemi gjyqësor;
- b) sigurohet që sjellja e tij të jetë dinjitoze në sytë e një vëzhguesi të arsyeshëm;...”;
- në Kreun II, titulluar “Parimet bazë të Kodit të Etikës Gjyqësore” dhe specifikisht në Seksionin “Ç”, titulluar “Parimi i sjelljes së hijshme dhe me vetëpërmbytje”, parashikon se:
- “9. Gjyqtari shmang sjelljen e pahijshme dhe shfaqjen e saj në të gjitha aktivitetet e tij. Si subjekt i vëzhgimit të vazhdueshëm publik, gjyqtari duhet të pranojë kufizime personale që mund të shihen si të paarsyeshme për një qytetar të thjeshtë dhe këtë duhet ta bëjë lirshëm dhe me dëshirë. Gjyqtari shmang çdo sjellje, e cila krijon dyshimin e arsyeshëm se vendimet e tij nxiten nga motive të tjera, përtej zbatimit të drejtë të ligjit. Gjyqtari sillet me vetëpërmbytje me synim arritjen e një balance mes të drejtave të tij si qytetar dhe kufizimeve që lidhen me funksionin e tij. Sipas këtij parimi, gjyqtari: ...
- c) nuk lejon që zyra e tij të përdoret për qëllime të tjera të ndryshme nga ato që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore; ...”.

VII. VLERËSIMI I KËSHILLI TË LARTË GJYQËSOR MBI KËRKESËN PËR MARRJEN E MASËS PROVIZORE TË PEZULLIMIT NGA DETYRA TË MAGJISTRATES {...}

29. Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon se kërkesa e ILD për pezullimin nga detyra të magjistrates {...} deri në përfundim të procedimit disiplinor duhet të pranohet, pasi vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë kushtet dhe shkaqet për marrjen e kësaj mase provizore.

30. Fillimisht, për të shmangur çdo konfuzion, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson të theksojë se masa e kërkuar në rastin konkret dhe për të cilën çmohet zbatimi i saj, pra pezullimi nga detyra i magjistratit deri në përfundim të procedimit disiplinor, është një masë provizore e ndryshme nga masa disiplinore sipas nenit 105, pika 1, shkronja “dh” dhe nenit 110, të Ligjit për Statusin.

31. Lidhur me zbatimin e masës provizore të pezullimit nga detyra të magjistrates {...}, nisur nga sa më lart u parashtrua, referuar rrethanave të rastit, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se në këtë rast evidentohet ekzistenca e kushteve lejuese të marrjes së kësaj mase në rrethanat kur:

- a) Znj.{...} është subjekt i ligjit që i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore, përcaktuar kjo në nenin 140 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pasi gëzon statusin e magjistratit ndërsa ushtron funksionin e gjyqtarit;
- b) Znj.{...} është subjekt i një procedimi disiplinor të filluar sipas ligjit (Ligjit për Statusin), nga organi i ngarkuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 147/d) dhe Ligji për Statusin me funksionin e ndjekjes disiplinore, pikërisht nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
- c) Ka një kërkesë për marrjen e kësaj mase nga organi i ndjekjes disiplinore (ILD), sikurse kërkon dhe përcakton neni 152, pika 1 dhe neni 153, shkronja “b”, të Ligjit për Statusin.

32. Sa i përket shkaqeve lejuese për marrjen e masës provizore të pezullimit nga detyra të magjistratit, ato përcaktohen në nenin 152, pika 2, të Ligjit për Statusin. Sipas kësaj dispozite, ligji lejon zbatimin e kësaj mase provizore në rast të ekzistencës të paktën të njërës prej tre situatave dhe konkretisht: i) kur vazhdimi i magjistratit në detyrë dëmton rezultatin e procedimit disiplinor; ii) kur vazhdimi i magjistratit në detyrë pengon konkluzionin e drejtë ose të rregullt të procedimit disiplinor; iii) kur vazhdimi i magjistratit në detyrë diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit. ILD në rastin konkret e ka mbështetur kërkesën e tij për marrjen e masës provizore ndaj magjistrates {...} sipas rastit (iii). Pra, sipas ILD, vazhdimi i në detyrë i znj. {...} diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit.

33. Përpara parashtrimin të arsyeve për ekzistencën e shkaqeve lejuese të marrjes së masës provizore të pezullimit nga detyra të magjistrates së proceduar disiplinorisht në rastin konkret, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson të theksojë se ky është rastin i parë kur atij, si organ qeverisës

i sistemit gjyqësor, i ngarkuar edhe me funksione disiplinore, i kërkohet zbatimi i institutit të pezullimit nga detyra të magjistratit (jo si masë disiplinore) mbi shkakun e fillimit të procedimit disiplinor ndaj tij.

34. Po ashtu, vlen të përmendet se deri në ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 (me Ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016), në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë nuk njihej instituti i pezullimit nga detyra të magjistratit (gjyqtarit). Po ashtu edhe legjislacioni në fushën e drejtësisë nuk e ka njohur këtë institut deri në vitin 2014, me miratimin e Ligjit nr. 101/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar”, ku me ndryshimet që i bënë nenit 21, në pikën 2, u parashikua se: *“2. Në rastin kur një gjyqtar merr cilësinë e të pandehurit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos pezullimin e gjyqtarit nga detyra derisa të merret vendim gjyqësor i formës së prerë”*.

35. Ndërkohë, me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë njohu institutin e pezullimit nga detyra të magjistratit (gjyqtarit), duke parashikuar rregullime të veçanta në nenin 140, pika 3, sipas të cilit: *“3. Gjyqtari pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor kur: a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale; b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje; c) kur fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit”*. Ndërsa në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj dispozite kushtetuese, kushtetutbërësi ka përcaktuar vetë rastet (faktet objektive) kur gjyqtari pezullohet nga detyra, duke qenë kështu ato drejtpërdrejt të zbatueshme, në rastin e shkronjës “c”, kushtetutbërësi ka autorizuar ligjvënësin për plotësimin e normës.

36. Mbi këtë autorizim kushtetues, në Ligjin për Statusin, ligjvënësi rregulloi institutin e pezullimit nga detyra të magjistratit përmes dispozitave të neneve 151 dhe 152.

36.1 Në nenin 152 të Ligjit për Statusin rregullohet *“Pezullimi i detyruar”*, duke u parashikuar si shkaqe pezullimi të magjistratit dy rastet që bëjnë fjalë dhe shkronjat “a” dhe “b”, pika 3, të nenit 140 të Kushtetutës.

36.2 Nga ana tjetër, në nenin 152 të Ligjit për Statusin u rregullua *“Pezullimi mbi bazë diskrecioni”*, duke u parashikuar se: *“1. Nëse Këshilli krijon bindjen se qëndrimi në detyrë i magjistratit të akuzuar paragjykon hetimin penal ose disiplinor, pengon përfundimin në mënyrë të drejtë ose të rregullt të hetimit penal ose disiplinor apo diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit, mund të pezullojë magjistratin nga detyra nëse: a) ndaj magjistratit ka nisur një hetim penal; b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të kryer nga pakujdesia; c) kanë filluar hetimet ose procedimet disiplinore për shkelje disiplinore. 2. Nëse Këshilli krijon bindjen, bazuar në provat e mjaftueshme, sipas parashikimeve të nenit 67, të këtij ligji, që magjistrati nuk mund të qëndrojë përkohësisht në detyrë për shkaqe që lidhen me shëndetin fizik ose mendor,*

mund ta pezullojë nga detyra magistratin. 3. Në rast se përfundon pezullimi i detyruar, Këshilli mund të vendosë pezullimin e magistratit në përputhje me këtë ligj”. Kjo dispozitë ligjore u shfuqizua nga Gjykata Kushtetuese me Vendimin nr. 34, datë 10.04.2017, me arsyetimin se: “58. ..., Gjykata vlerëson se ligjvënësi në nenet ... dhe 152 ka parashikuar raste të tjera ... pezullimi për magistratin, në mungesë të delegimit të shprehur të nenit 140 të Kushtetutës, duke cenuar kështu nenin 116 të Kushtetutës. ...”.

36.2.1 Pas shfuqizimit nga Gjykata Kushtetuese të nenit 152 të Ligjit për Statusin, ligjvënësi, përmes Ligjit nr. 48/2019, miratoi një dispozitë të re, të titulluar “*Pezullimi në rastin e procedimit disiplinor*”, në të cilën u parashikua se: “1. Kur Këshilli krijon bindjen se vazhdimi në detyrë i magistratit, për të cilin është paraqitur kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor, sipas nenit 138, të këtij ligji, dëmton rezultatin e procedimit disiplinor, pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt, ose diskrediton rëndë pozitën dhe figurën e magistratit, mund të vendosë pezullimin e tij nga detyra. 2. Pezullimi, sipas këtij neni, zgjat deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Këshilli mbi kërkesën për procedim disiplinor, me përjashtim të rastit kur Këshilli vendos të revokojë pezullimin, sipas nenit 156, të këtij ligji”.

36.2.2 Përmbajtja e nenit 152 të Ligjit për Statusin u ndryshua përsëri nga ligjvënësi me Ligjin nr. 15/2020, ku tashmë kjo dispozitë parashikon se: “1. Kur ka dyshim të arsyeshëm se vazhdimi i magistratit në detyrë dëmton rezultatin e procedimit disiplinor, pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt, ose diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magistratit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen menjëherë një hetim paraprak për të verifikuar besueshmërinë e burimit të informacionit, sipas nenit 124, të këtij ligji, ose ankesës së paraqitur nga subjektet e përcaktuara në nenin 119 të këtij ligji. Kur Inspektori i Lartë i Drejtësisë krijon bindjen se burimi i informacionit ose ankesa është e besueshme, brenda 3 ditëve nga marrja e ankesës ose nga momenti që ka marrë dijeni për shkeljen e pretenduar, i paraqet Këshillit përkatës raport të arsyetuar, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura deri në atë moment për fillimin e një procedimi disiplinor dhe kërkesën për pezullimin e magistratit nga detyra. 2. Këshilli, për rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, ose në nenin 138, të këtij ligji, pezullon magistratin nga detyra, kur vazhdimi i magistratit në detyrë dëmton rezultatin e procedimit disiplinor, pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt, ose diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magistratit. Këshilli mund të kërkojë, informacion mbi shkeljen e pretenduar pranë çdo institucioni publik ose subjekti privat. Në rastin e procedimit disiplinor, sipas pikës 1, të këtij neni, Këshilli vendos menjëherë, por jo më vonë se tre ditë nga data e paraqitjes së kërkesës, duke i dhënë mundësinë magistratit për të parashtruar argumentet e tij në mbledhjen e Këshillit. 3. Pezullimi, sipas këtij neni, zgjat deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Këshilli mbi kërkesën për procedim disiplinor, me përjashtim të rastit kur Këshilli vendos të revokojë pezullimin, sipas nenit 156 të këtij ligji. 4. Pavarësisht parashikimeve të nenit 138, pika 5, të këtij ligji, Këshilli, kur çmon se ka nevojë për hetime të mëtejshme për shkeljen disiplinore, i kërkon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të kryejë këto hetime, pa qenë nevoja për të specifikuar

elementet që mungojnë dhe afatin. Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen me përparësi hetime të mëtejshme për këto shkelje dhe i paraqet Këshillit raportin dhe dosjen e hetimit”.

37. Nga sa më lart u parashtrua, mund të konstatohet se për institutin e pezullimit nga detyra të magjistratit nuk ka praktika të mëparshme, ndërkohë që Këshilli i Lartë Gjyqësor do të duhet të zbatojë në rastin konkret nenin 152 të Ligjit për Statusin përmes interpretimit të kësaj dispozite, pikërisht të rasteve që parashikohen prej saj si shkak pezullimi, kjo në raport me rrethanat e rastit konkret. Rastet shkak pezullimi i detyruar përmbajnë fakte objektive lehtësisht të verifikueshme dhe për të cilat nuk kërkohet vlerësim, pasi një gjë të tillë e ka bërë ligjvënësi kushtetues. Ndërkohë situata paraqitet ndryshe sa i përket rasteve shkak pezullimi në rastin e procedimit disiplinor. Për këto të fundit kërkohet verifikimi i rrethanave të caktuara faktike, mbi të cilët të mund të vlerësohet se vazhdimi në detyrë i magjistratit dëmton rezultatin e procedimit disiplinor ose pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt. Dhe përtej kësaj, një prej rasteve shkak pezullimi në rastin e procedimit disiplinor, përveç një vlerësimi mbi mundësinë e diskreditimit të figurës dhe pozitës së magjistratit nga sjellja e magjistratit të proceduar, kërkon edhe një vlerësim konkret për shkallën e këtij diskreditimi, çka në fakt është e lidhur ngushtë me themelin e procedimit disiplinor, ndaj konsiderimi i një shkakut të tillë pezullimi, kërkon kujdes në trajtim për të mos lënë shkas për paragjykim të themelit të procedimit disiplinor.

38. Duke ardhur në rastin konkret, konstatohet se kërkesa për marrjen e masës provizore të pezullimit nga detyra të magjistrates {...} është bërë në kuadër të një procedimi disiplinor të filluar ndaj saj për shkelje disiplinore të klasifikuara nga ligji si “*Shkelje disiplinore jashtë funksionit*”, referuar nenit 103 të Ligjit për Statusin. Në këtë dispozitë, listohen një sërë rastesh konkrete sjelljeje të magjistratit që përbëjnë *shkelje disiplinore jashtë funksionit*, por lista nuk është shtruese, ndërsa në shkronjën “dh”, si shkelje disiplinore të këtij lloji parashikohet edhe çdo lloj tjetër sjelljeje që diskrediton pozitën dhe figurën e magjistratit dhe dëmton besimin e publikut në sistemin gjyqësor, e kryer jashtë ushtrimit të detyrës, pra jo duke ushtruar funksionet zyrtare, me fjalë të tjera sjellja/veprimtaria jashtëgjyqësore e tij. Rregulli sipas kësaj shkronje të dispozitës në fjalë është në fakt një “*normë blanket*”, pra që referon në norma të tjera ligjore që normojnë sjelljen jashtë funksionit të magjistratit, në rastin konkret gjyqtarit. Ndër këto norma, mund të përmendet ato të Ligjit për Statusin, pikërisht nenet 3 (*Vlerat themelore*) dhe 4 (*Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes*) të tij. Po ashtu, të tilla janë edhe ato të Kodit të Etikës Gjyqësore, akt nënligjor ky i miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas autorizimit të dhënë nga ligji, neni 4, pika 3, i Ligjit për Statusin dhe neni 83, pika 1, i Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar⁹.

39. Me tej, referuar faktit disiplinor në rastin konkret, konstatohet se ai lidhet me sjelljen jashtëgjyqësore të magjistrates {...} dhe pikërisht me shfaqjen e saj në publik, përmes publikimit në një rrjet social (TikTok) të videove me imazhin e saj personal, të bëra në zyrën apo ambientet e

⁹ “Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për miratimin e standardeve të etikës gjyqësore dhe të rregullave të sjelljes të gjyqtarëve, si dhe për mbikëqyrjen e respektimit të tyre. ...”.

gjykatës ku ushtron funksionin dhe në një automjet, pamjet të cilat, sipas ILD, paraqesin një sjellje provokuese të saj, të shoqëruar në sfond me muzikë të natyrës jo të hijshme dhe të përshtatshme për imazhin e një magjistrati.

40. Në konsideratë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në çdo shoqëri demokratike dhe në çdo shtet ligjor, drejtësia përbën një nga shtyllat vertebrale të saj, ndaj është e nevojshme që publiku të ketë besim tek drejtësia. Por që të ekzistojë ky besim tek qytetarët duhet që profesionistët e drejtësisë të ofrojnë besueshmëri përmes një sjelljeje të hijshme/të paqortueshme etike dhe profesionale. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se gjyqtarët, si profesionistë të drejtësisë, janë zyrtarë shumë të rëndësishëm sepse autoriteti i tyre shtrihet në çdo sferë të jetës shoqërore. Kjo rëndësi e veçantë e tyre vjen pikërisht nga funksioni publik që ushtrojnë, ndërsa ata, në konfliktet gjyqësore që zgjidhin, përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, përveç se vendosin për çështje të rëndësishme të sektorit publik dhe privat, sikundër edhe për veprime të zyrtarëve të tjerë shtetërorë dhe publikë. Është pikërisht ky pushtet kaq i madh ai që imponon për gjyqtarët respektimin e standardeve më të larta të sjelljes, brenda dhe jashtë gjykatës, çka përbën faktorin kyç dhe kryesor në ruajtjen e integritetit dhe pavarësisë së gjyqësorit dhe në këtë mënyrë rritjen e besimit të publikut tek drejtësia.

41. Në vijim, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka në konsideratë se gjyqtari, si gjatë kryerjes së detyrës, ashtu dhe jashtë saj, pra në jetën profesionale dhe atë personale, qoftë në jetën reale dhe atë virtuale, ndërsa nuk mund dhe nuk duhet të jetë një qenie e izoluar nga shoqëria, duhet të udhëhiqet nga Parimet e Bangalorit të Sjelljes Gjyqësore, të mishëruara dhe në Kodin e Etikës Gjyqësore, të shoqëruara dhe me komentet përkatëse për çdo parim. Në çdo rast gjyqtari duhet të shfaq një sjellje të hijshmet/të paqortueshme dhe me vetëpërmbajtje, sepse kështu ndihmon në ruajtjen dhe forcimin e dinjitetit të funksionit të tij, por edhe të reputacionit të sistemit gjyqësor.

42. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka në konsideratë dhe atë çfarë Gjykata Kushtetuese ka theksuar më shumë se një herë se: *“Drejtësia mund të jetë e besueshme dhe me integritet kur jepet nga gjyqtarë që nuk ngjallin dyshime sa i takon figurës së tyre”*¹⁰.

43. Mbi sa më lart u parashtrua, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë të dhëna që ngrenë dyshime për sjellje jo të hijshme/të qortueshme të magjistrates {...}, jashtë ushtrimit të funksionit, e shfaqur në rrjetet sociale. Përdorimi i rrjeteve sociale nuk është i ndaluar për gjyqtarin, por ai ka detyrimin të shmang çdo sjellje të pahijshme/të qortueshme dhe shfaqjen e saj, për sa kohë është subjekt i vëzhgimit të vazhdueshëm publik. Megjithatë, Këshilli i Lartë Gjyqësor konstaton se magjistratja e proceduar disiplinarisht, në vijimësi, ka mohuar shfaqjen tek të tretë, publikimin në rrjetet sociale, të videove të saj personale, përmbajtja e të cilave ngre dyshime për sjellje jo të hijshme/të qortueshme të saj. Pavarësisht kësaj, organi i ndjekjes disiplinore (ILD), përveç marrjes së deklarimeve të magjistrates, nuk ka hetuar në këtë drejtim, ndërsa ka arritur në përfundimin se mbetet i paprovuar fakti i përdorimit nga magjistratja

¹⁰ Vendimi nr. 34, datë 10.04.2017 dhe Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017.

të rrjeteve sociale, në bazë të parimit se “*çdo dyshim shkon në favor të magjistratit*”. Duket që ka një kontradiktë mes shkeljes së atribuar magjistrates, me përfundimin se mbetet i paprovuar fakti i përdorimit nga magjistratja i rrjeteve sociale. Në fakt videot personale të magjistrates, mbi të cilat bazohet shkelja disiplinore ndaj saj, pranohet të jenë marrë në rrjetet sociale (rrjeti social “TikTok”, llogaria {...}supozuar e magjistrates), nga mediat vizive dhe ato online, të cilat më pas i kanë publikuar për publikun e gjerë, çka më pas ka shërbyer si indicje për ILD, për fillimin me iniciativë të hetimit disiplinor ndaj saj.

44. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se tashmë është fakt se videot personale të magjistrates janë publikuar në mediat sociale, vizive dhe ato online, ndaj publiku i gjerë është njohur dhe kushdo ka pasur mundësinë të tërheq dhe të shpreh vlerësimet e tij rreth vetëpërbajtjes dhe hijeshisë/paqortueshmësisë së sjelljes së magjistrates të shfaqur në ato video, mbi supozimin se është vetë magjistratja që i ka publikuar ato në rrjetet sociale. Nga ana tjetër, Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi disiplinor i gjyqtarëve, i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji, do të duhet të trajtojë ligjërisht rastin dhe të ndërmarr, nëse është vendi, veprimin ligjor përkatës.

45. Por Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se hetimi disiplinor nuk është i mjaftueshëm për të arritur në një konkluzion të drejtë dhe të rregullt mbi procedimin disiplinor të filluar ndaj magjistrates, ndërsa për të konkluduar që shkelja disiplinore e atribuar magjistrates ka ndodhur dhe, më tej, për rëndësinë e saj, shkallën e fajësisë, motivet, etj, çmon mjaft të rëndësishëm verifikimin e faktit nëse videot personale të magjistrates, të regjistruara nëpërmjet telefonit celular të saj sikurse ajo pranon, janë publikuar ose jo prej saj dhe nëse po, rrethin e personave që u ka krijuar akses për shikimin e tyre, për të kuptuar kështu nëse magjistratja ka dëshiruar të shfaqej në atë mënyrë përpara të tretëve dhe në eventualitet përpara publikut të gjerë apo kjo ka ngjarë nga pakujdesia e saj (qoftë dhe nga mosmarrja e masave të duhura) ose keqdashja e dikujt, siç ajo pretendon. Për verifikimin e këtij fakti është i nevojshëm marrja e mendimit të një eksperti në fushën e teknologjisë së informacionit, provë kjo e lejueshme në kuptim të Ligjit për Statusin, çka për të cilën nga ana tjetër, kërkohet edhe bashkëpunimi i magjistrates së proceduar disiplinorisht. Eksperti do të duhet të verifikojë dhe të sjell të dhëna për kohën dhe mënyrën e realizimit të videove nga magjistratja, aplikacionin e përdorur nga ajo, si dhe për mënyrën dhe kohën e publikimit të tyre, ku janë publikuar ato fillimisht dhe nga kush.

46. Gjatë hetimit disiplinor janë administruar 8 DVD me pamje të kamerave të sigurisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nga ku nuk kanë rezultuar të dhëna të vlefshme për objektin e hetimit disiplinor, pasi memorja e tyre është vetëm 4/ditë, ndërsa videot janë publikuar në datat 14, 15 dhe 20 maj. Kjo e dhënë nuk përputhet me përcaktimet e VKM nr. 538, datë 03.07.2020, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për garantimin e rregullit dhe të sigurisë në gjykata”, ku parashikohet si një prej rregullave bazë që duhet të përmbushen është dhe “*pajisja me sistemin e kamerave të vëzhgimit të lidhura me dedektorë alarmi dhe atë elektronik të lejimit të hyrjes në godinë si dhe me server të ruajtjes së këtyre të dhënave për një periudhë deri në 2 muaj*” (neni 4, pika iv). Ndërkohë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me

Shkresën nr. 581/1 prot. datë 02.11.2020, ka njoftuar Këshillin e Lartë Gjyqësor se në këtë gjykatë përmbushen të gjitha kushtet e kërkuara nga akti nënligjor në fjalë lidhur me kushtet e sigurisë dhe se nuk kishte nevojë të tjera në këtë drejtim. Nisur nga kjo, në kuadër të të dhënave për të cilat kërkohen njohuri të posaçme teknike, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se është e nevojshme edhe këqyrja nga eksperti të kamerave të sigurisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, jo vetëm të katit ku ndodhet ashensori dhe zyra e magjistrates, por edhe në ambientet e tjera të gjykatës, në datat e publikimit të videove të magjistrates, në funksion të ballafaqimit të të dhënave dhe arritjen e konkluzioneve të sakta.

47. Po ashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se për të arritur në një konkluzion të drejtë dhe të rregullt mbi procedimin disiplinor të filluar ndaj magjistrates, është i nevojshëm dokumentimi i tekstit të këngëve që shoqërojnë në sfond muzikor videot me imazhin personal të magjistrates, që nga ILD janë vlerësuar me natyrë jo të hijshme dhe të përshtatshme për imazhin e një magjistrati.

48. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se për të arritur në një konkluzion të drejtë dhe të rregullt mbi procedimin disiplinor të filluar ndaj magjistrates, është i nevojshëm administrimi i të dhënave profesionale të magjistrates, në drejtim të rezultateve në punë, eficientë dhe produktivitetin e saj. Të dhënat profesionale të magjistratit përcaktohen si një nga kriteret e caktimit të masës disiplinore sipas nenit 115, pika 1, shkronja “ç”, të Ligjit për Statusin, ndaj në çdo rast është i nevojshëm administrimi i këtyre të dhënave.

49. Mbi sa sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë shkaqet për marrjen e masës provizore të pezullimit nga detyra të magjistrates {...} në zbatim të nenit 152, pika 2, të Ligjit për Statusin, duke vlerësuar se ky pezullim është në interes të detyrës, por edhe referuar natyrës së shkeljes që i është atribuar asaj, duke vlerësuar se vazhdimi në detyrë i magjistrates së proceduar disiplinorisht, në kontekstin e kryerjes së hetimeve të mëtejshme për shkeljen disiplinore, do të dëmtonte rezultatin e procedimit disiplinor dhe pengonte arritjen e një konkluzioni të drejtë dhe të rregullt në lidhje me të.

50. Po ashtu, sikurse u parashtrua, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë shkaqet për t'i kërkuar ILD kryerjen e hetimeve të mëtejshme për shkeljen disiplinore të atribuar magjistrates {...} në zbatim të nenit 152, pika 4, të Ligjit për Statusin, për elementet e munguar si më lart. Por pavarësisht specifikimit më sipër të këtyre elementeve të munguar, ILD mund hetime të mëtejshme edhe në çdo aspekt tjetër që mund të vlerësojë të nevojshme dhe të dobishme për shkeljen disiplinore.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 140 pika 3, shkronja “c” dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 61, pika 2, shkronja “b”, nenin 97, pika 1,

shkronja “a” dhe nenin 100, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 152, pika 2 dhe 4 dhe nenin 155, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Pezullimin nga detyra të magjistrates {...}, me detyrë Zëvendëskryetare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, deri në përfundimin e procedimit disiplinor, iniciuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me Vendimin nr. 2569/12, datë 01.06.2021.
2. T’i kërkohet ILD të kryejë hetime të mëtejshme në drejtim të shkeljes disiplinore të atribuar magjistrates {...}.
3. Kundër këtij vendimi, sipas pikës 1 të tij, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve, afat i cili fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet magjistrates {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas kërkesave të nenit 98, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR